



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare e mbajtur më 17 prill 2019, pas interpelancës së zhvilluar me kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, me kërkesë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, në lidhje me moscaktimin dhe rritjen e pagës minimale në Republikën e Kosovës, me 30 maj 2019, e miratoi këtë:

**REZOLUTË**

*Në lidhje me moscaktimin dhe rritjen e pagës minimale në Republikën e Kosovës*

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Këshilli Ekonomiko-Social që në mbledhjen e radhës të vendosë dhe t'ia propozojë Qeverisë së Kosovës pagën minimale sipas Ligjit nr. 03/L-212 të punës, konkretisht nenit 77.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që pas propozimit nga KES, paga minimale të përcaktohet në fillim të çdo viti kalendarik. Në mënyrë që paga minimale të shërbejë si instrument për luftimin e varfërisë, niveli i saj duhet ta reflektojë dinamikën dhe ndryshimet e indikatorëve ekonomikë, sidomos shkallën e inflacionit, pra ndikimin të fuqia blerëse.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Këshilli Ekonomiko-Social që për caktimin e nivelit të pagës minimale ta marrë parasysh nevojën e domosdoshme që ka Republika e Kosovës për luftimin e varfërisë dhe reduktimin e pabarazisë.
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës rikonfirmon përkushtimin mbi parimin e pagës së njëjtë për punën e njëjtë. Zbatimi i pagës minimale duhet të shtrihet te të gjithë punëtorët pa asnjë dallim. Ndarja moshore që praktikohet aktualisht me 130 euro pagë minimale për të rinjtë deri në 35 vjeç, të hiqet menjëherë! Kjo ndarje i diskriminon të rinjtë, siç janë diskriminuese shumë raste kur gratë për punën e njëjtë marrin pagë më të ulët.



5. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që t'i rrisë angazhimet institucionale për zbatimin e pagës minimale të zbatohet te secili sektor i ekonomisë në Republikën e Kosovës.
6. Obligohet Këshilli Ekonomiko-Social dhe Qeveria e Kosovës që këtë rezolutë ta zbatojnë brenda tridhjetë (30) ditëve nga miratimi i saj.

Nr. 06-R-019  
Prishtinë, më 30 maj 2019

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Rezoluta u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Arkivit të Kuvendit.

